



Nr. 5 Prot.

Dt.22.03.2016

Objekti: Hapja e procesit të regjistrimit të kandidatëve për autoritetet dhe organet drejtuese në UART

VENDIM

Bazuar në ligjin Nr.8485, dt. 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenit 131 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 110, dt. 15.05.2016 dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në insitucionet publike të arsimit të lartë ne Republikën e Shqipërisë";

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve vendosi hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për autoritetet dhe organet drejtuese në UART, Rektor dhe Senatin Akademik.

Të gjithë të interesuarit për t'u vetëkandiduar për Rektor dhe Senatin Akademik (anëtarë të personelit akademike dhe studentë) duhet të plotësojnë formularin e vetëkandimit për këtë pozicion.

Në bazë të Nenit 24, Pika 2 të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në insitucionet publike të arsimit të lartë ne Republikën e Shqipërisë": " – Kandidatët për senatin akademik përfaqshues të studentëve , propozohen nga jo më pak se 30 studentë, pjesë e trupës zgjedhore".

Formulari i vetëkandidimit tërhiqet pranë zyrës së KIZ.

Dorëzimi i aplikimit bëhet pranë KIZ me zyrë në: godinën qendrore të UART, kati I, korridori Jugor.

Afati i fundit i pranimit të aplikimeve është Ditën e dielë dt.27.03.2016, ora16.00.

Kryetar


Alert Çeloaliaj

Anëtar Arben Basha

Anëtar Petraq Papa

Anëtar Helidon Goro

Anëtar Elfa Grabova

SEKRETARE

Taulanda Jupi

